



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 472 Prot.

Tiranë, më dt. 24. 11.2017

**VENDIM**

**Nr. 357, dt. 24.11.2017**

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 75, datë 03.04.2015 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 24.11.2017 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për *Prof. Dr. Neritan Ceka*,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi profesionale individuale në fushën e restaurimeve për kategorinë **AP. “Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”**, me nënkategoritë **AP/1, AP/2 dhe AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”** me nënkategoritë **AZ/1, AZ/2**, sipas rregullore “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të Prof. Dr. Neritan Ceka.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e Prof. Dr. Neritan Ceka me licensë restaurimi profesionale individuale në fushën e restaurimeve për kategorinë **AP. “Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”**, me nënkategoritë **AP/1, AP/2, dhe AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”** me nënkategoritë **AZ/1, AZ/2**.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Mirela Kumbaro Furxhi**

**SEKRETAR I KKR I DELEGUAR**

**Arta Dollani**

